

LIGJI

PËR ZGJEDHJEN, PËRDORIMIN DHE SHFAQJEN PUBLIKE TË SIMBOLEVE NACIONALE

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Pjesëtarët e popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera pakicë në Mal të Zi kanë të drejtën e zgjedhjes, përdorimit dhe shfaqjes në publik të simboleve kombëtare, në mënyrë dhe me kushte të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 2

Simbole nacionale, sipas këtij ligji, konsiderohen simbolet të cilat pjesëtarët e popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale i përdorin për të shprehur identitetin e vet nacional.

II. ZGJEDHJA DHE PËRDORIMI I SIMBOLEVE NACIONALE

Neni 3

Simbolet nacionale, sipas këtij ligji, janë stema dhe flamuri.

Etaloni i simboleve nacionale sipas paragrafit 1 të këtij neni përcaktohet me një vendim të Këshillit të Popullit Pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli), siç parashikohet me statut.

Vendimin për etalonin e stemës dhe etalonin e flamurit e konfirmon Kuvendi i Malit të Zi. Origjinali i stemës dhe origjinali i flamurit ruhen tek autoriteti i administratës shtetërore që është kompetent për të drejtat e pakicave (në tekstin e mëtejshëm: Ministria).

Neni 4

Stema dhe flamuri përdoren në formë dhe përmbajtje të përcaktuara.

Neni 5

Stema mund të përdoret:

- 1) Në vulën e Këshillit;
- 2) Në vulat e shoqatave arsimore, kulturore dhe fetare, të cilat i formojnë pjesëtarët e popullit pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë;
- 3) Në lokalet e Këshillit dhe të shoqatave arsimore, kulturore dhe fetare, të cilat i formojnë pjesëtarët e popullit pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë dhe në mbishkrimet në godinat në të cilat janë të vendosura këto shoqata;
- 4) Në aktet me të cilat shërbehen Këshillat dhe shoqatat arsimore, kulturore dhe fetare, të cilat i formojnë pjesëtarët e popullit pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë;
- 5) Në kartat/statutet, diplomat dhe mirënjohjet të cilat i japin Këshillat dhe shoqatat arsimore, kulturore dhe fetare, të cilat i formojnë pjesëtarët e popullit pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë;

- 6) Në fletëfalenderimet, urimet, ftesat dhe në aktet e tjera të këshillave dhe shoqatave arsimore, kulturore dhe fetare, të cilat i formojnë pjesëtarët e popullit pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë;
- 7) Me rastin e tubimeve politike, shkencore, kulturo-artistike, sportive dhe tubimet e tjera në organizimin privat ose në organizimin e Këshillit, partive politike, organizatave joqeveritare, shoqatave ose individëve;
- 8) Në rastet e tjera të parapara me ligj.

Neni 6

Flamuri mund të vendoset:

- 1) Në godinat dhe lokalet në të cilat janë të vendosura këshillat dhe shoqatat arsimore, kulturore dhe fetare, të cilat i formojnë pjesëtarët e popullit pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë;
- 2) Në godinat dhe lokalet në të cilat janë të vendosura këshillat dhe shoqatat arsimore, kulturore dhe fetare, të cilat i formojnë pjesëtarët e popullit pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë në ditë zie, të cilën e përcakton Këshilli, flamuri shfaqet në gjysmë të shtizës;
- 3) Me rastin e tubimeve politike, shkencore, kulturo-artistike, sportive dhe tubimet e tjera në organizimin privat ose në organizimin e Këshillit, partive politike, organizatave joqeveritare, shoqatave ose individëve;
- 4) Në rastet e tjera të parapara me ligj;

Neni 7

Simbolet nacionale nuk mund të përdoren në rastet në vijim:

- 1) Para dhe në objektin e Kuvendit të Malit të Zi, Presidentit të Malit të Zi, Qeverisë së Malit të Zi, Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi, Prokurorisë Shtetërore, Mbrojtësit të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Ushtrisë së Malit të Zi, Drejtorisë së Policisë, Bankës Qendrore të Malit të Zi dhe Institucionit Shtetëror të Auditimit;
- 2) Me rastin e takimeve ndërkombëtare, politike, shkencore, kulturo-artistike, sportive dhe tubimet e tjera në organizimin e organeve nga pika 1 e këtij neni, si dhe në tubimet e tjera në të cilat prezantohet Mali i Zi;
- 3) Në rastet e tjera të parapara me ligj;

Neni 8

Në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat pjesëtarët e popullit pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë përbëjnë popullatën shumicë në ditët e festave shtetërore dhe festat nacionale të popullit pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë, para objektit të organit të vetëqeverisjes dhe administratës lokale, krahas simboleve shtetërore, vendosen edhe simbolet nacionale të popullit pakicë gjegjësisht ose të një komuniteti tjetër pakicë.

Në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat pjesëtarët e popullit pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë përbëjnë popullatën shumicë përdorimi i simboleve nacionale është i lejuar edhe në objektet e organit të vetëqeverisjes dhe administratës lokale.

Neni 9

Në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat pjesëtarët e popullit pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë nuk e përbëjnë popullatën shumicë, në ditët e festave nacionale të popullit pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë, para objektit të organit të vetëqeverisjes dhe administratës lokale, krahas simboleve shtetërore, shfaqen edhe simbolet nacionale të popullit pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë, e cila përbën mbi 15% të popullatës së kësaj vetëqeverisjeje lokale.

Në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat pjesëtarët e popullit pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë nuk e përbëjnë popullatën shumicë, është i lirë përdorimi i simboleve nacionale të popullit pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë, i cili përbën mbi 15% të popullatës së kësaj vetëqeverisjeje lokale edhe në objektet e organit të vetëqeverisjes dhe administratës lokale.

Neni 10

Në lokalet e vetëqeverisjes vendore të dedikuara për kurorëzim lejohet përdorimi i lirë i simboleve nacionale.

Neni 11

Mënyra më e afërtë e përdorimit dhe shfaqjes publike të simboleve nacionale në njësitë e vetëqeverisjes lokale do të përcaktohet me rregulloren e njësisë së vetëqeverisjes lokale.

III. MBROJTJA E SIMBOLEVE KOMBËTARE

Neni 12

Në simbolet nacionale nuk lejohet që asgjë të përmirësohet, shtohet ose ndysohet.

Në raste të posaçme, me miratimin paraprak të Këshillit, simbolet nacionale mund të përdoren si pjesë e emblemave, gjegjësisht simbole të institucioneve nacionale.

Neni 13

Simbolet nacionale nuk mund të përdoren në formë identike me simbolet e partisë politike, sipërmarrjes, institucionit dhe subjektit ose organizatës tjetër juridike.

Simbolet nacionale nuk mund të përdoren si një shenjë e markës tregtare ose shërbimit, model, ose mostër dhe as si çfarëdo shenje tjetër që shënon mallrat ose shërbimet.

Neni 14

Simbolet nacionale nuk lejohet të përdoren nëse janë të dëmtuara, ose nëse, për shkak të pamjes, janë të papërshtatshme për përdorim.

Neni 15

Flamuri ngritet, ulet, vendoset dhe hiqet, gjegjësisht bartet me nderime të zakonshme (me ngritje në këmbë, përshëndetje, etj.)

Neni 16

Nuk lejohet që flamuri të vendoset ashtu që ai të prekë tokën, as si shtrojë, perde dhe ngjashëm.

Neni 17

Kur përdoren simbolet nacionale, gjegjësisht kur ngriten krahas simboleve shtetërore, simboli shtetëror zë vendin e nderit.

IV. MBIKËQYRJA

Neni 18

Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe rregulloreve të miratuara në bazë të këtij ligji e bën Ministria dhe organet përkatëse të qeverisjes lokale.

Kontrolli i inspektimit kryhet nga autoriteti përgjegjës për aktivitetet e inspektimit dhe organi përkatës i qeverisjes lokale, përmes inspektorëve komunal.

V. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 19

Me gjobë në të holla prej 2.000 euro deri në 20.000 euro personi juridik do të dënohet për kundërvajtje, nëse:

- 1) përdor stemën ose flamurin në formë dhe përmbajtje të cilat nuk janë përcaktuar (neni 4);
- 2) përdor simbolet nacionale para dhe brenda objekteve të Kuvendit të Malit të Zi, Presidentit të Malit të Zi, Qeverisë së Malit të Zi, Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi, Prokurorisë Shtetërore, Mbrojtësit të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Ushtrisë së Malit të Zi, Drejtorisë së Policisë, Bankës Qendrore të Malit të Zi dhe Institucionit Shtetëror të Auditimit (neni 7, paragrafi 1, pika 1);
- 3) përdor simbolet nacionale gjatë takimeve ndërkombëtare, takimeve politike, shkencore, kulturo-artistike, sportive dhe tubimet e tjera në organizimin e organeve nga neni 7, paragrafi 1, pika 1 e këtij ligji, si dhe tubimet në të cilat prezantohet Mali i Zi (neni 7, paragrafi 1, pika 2);
- 4) në simbolet nacionale diçka përmirëson, shton ose ndyshon (neni 12 paragrafi 1);
- 5) përdor simbolet nacionale si pjesë e emblemave, gjegjësisht simboleve të institucioneve nacionale pa miratimin e mëparshëm të Këshillit të popullit përkatës (neni 12 paragrafi 2);
- 6) përdor simbolet nacionale në formë identike si simbole të partisë politike, sipërmarrjes, institucionit dhe subjektit ose organizatës (neni 13 paragrafi 1);
- 7) përdor simbolet nacionale si një shenjë e markës tregtare ose e shërbimit, model ose mostër dhe si çfarëdo shenje tjetër që shënon mallrat ose shërbimet (neni 13 paragrafi 2);
- 8) përdor simbolet nacionale të cilat janë të dëmtuara, ose nëse për shkak të dukjes nuk janë të përshtatshme për përdorim (neni 14);
- 9) flamurin e vendos ashtu që ai e prekë tokën, shërben si shtrojë ose perde dhe ngjashëm. (neni 16);
- 10) simboli shtetëror nuk zë vendin e nderit me rastin e përdorimit, gjegjësisht vendosjes së simboleve nacionale krahas simboleve shtetërore (neni 17).

Për kundërvajtje, sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të dënohet personi përgjegjës në subjektin juridik me gjobë prej 300 euro deri në 2.000 euro.

Për kundërvajtje, sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të dënohet sipërmarrësi me gjobë prej 500 euro deri në 6.000 euro.

Për kundërvajtje, sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të dënohet personi fizik me gjobë prej 300 euro deri në 2.000 euro.

Neni 20

Kryerësit e kundërvajtjeve, sipas nenit 19, paragrafi 1 i këtij ligji, krahas gjobës si masë mbrojtëse mund të sanksionohen me konfiskimin e lëndës me të cilës është kryerë kundërvajtja.

VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 21

Statutet e njësive të vetëqeverisjes lokale do të harmonizohen me këtë ligj më së largu në afatin prej 18 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 22

Statutet e Këshillave do të harmonizohen me këtë ligj më së largu në afatin prej 60 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji .

Neni 23

Etaloni i simboleve nacionale do të përcaktohet në afatin prej 90 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji .

Neni 24

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushon të jetë në fuqi Ligji për përdorimin e simboleve nacionale ("Gazeta Zyrtare e RMZ", numëri 55/00) dhe neni 107 i Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit me të cilat janë përcaktuar dënimet me para për kundërvajtje ("Gazeta Zyrtare e MZ", numëri 40/11).

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Malit të Zi".

SH P J E G I M I

I BAZA KUSHTETUESE PËR MIRATIMIN E LIGJIT

Baza kushtetuese për miratimin e ligjit është e përmbajtur në nenin 79 pika 2 e Kushtetutës së Malit të Zi, me të cilën pjesëtarëve të popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera pakicë u garantohet e drejta dhe liria e zgjedhjes, përdorimit dhe vendosjes publike të simboleve nacionale, si dhe shënimi i festave nacionale.

II ARSYET PËR MIRATIMIN E LIGJIT

Ligji për përdorimin e simboleve nacionale është miratuar në vitin 2000. Me këtë ligj përcaktohet përdorimi i simboleve nacionale të pjesëtarëve të grupeve nacionale dhe etnike në Mal të Zi. Meqenëse koha e ka tejkaluar këtë ligj, me miratimin e Kushtetutës së re të Malit të Zi dhe për shkak të mangësive të tij në pjesën e zgjedhjes së simboleve nacionale etj., është vendosur të hartohet ligji i ri.

Mali i Zi është definuar me kushtetutë si shtet qytetar, demokratik, ekologjik dhe shtet i drejtësisë sociale, bazuar në sundimin e ligjit. Bartësi i sovranitetit është qytetari i cili e ka shtetësinë malazeze. Krahas kësaj, Kushtetuta definojnë edhe të drejtat e posaçme të pakicave. Duke pasur parasysh një rregullim kushtetues të këtillë, me këtë ligj u mundësohet pjesëtarëve të popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera pakicë, gjegjësisht popujve si kolektivitete, zgjedhja dhe përdorimi i simboleve të veta nacionale. Mali i Zi është shtet multi-etnik, kështu që me simbole shtetërore prezantohet Mali i Zi dhe shprehet përkatësia Malit të Zi, kurse me simbolet nacionale shprehet identiteti nacional.

Në praktikë, shumë shpesh gjatë tubimeve të ndryshme publike, manifestimeve dhe ngjarjeve të tjera, përdoren simbole të ndryshme, para së gjithash flamuj, për të cilët nuk ekzistojnë njohuri se kush i ka përcaktuar, të kujt janë, gjegjësisht identitetin e kujt e shprehin etj. Një situatë e ngjashme është edhe kur është fjala për përdorimin e simboleve në organet e administratës shtetërore ose vetëqeverisjes lokale, si dhe kur është çështja e përdorimit privat të simboleve.

Me këtë ligj definohet zgjedhja, përdorimi dhe shfaqja e simboleve nacionale, si në raste publike ashtu edhe në ato private, dhe në këtë mënyrë definohen qartë situatat kur është i ndaluar përdorimi i simboleve nacionale.

III PËRPUTHSHMËRIA ME LEGJISLACIONIN EVROPIAN DHE TRAKTATET E RATIFIKUARA NDËRKOMBËTARE

Krahas ekzistimit të direktivave nga fusha e të drejtave të njeriut, e të cilat kanë të bëjnë me disa fusha të veçanta për realizimin e këtyre të drejtave, fusha të cilën e trajton Drafti i Ligjit për zgjedhjen, përdorimin dhe vendosjen publike të simboleve nacionale është përcaktuar me dispozitat që i përkasin të ashtuquajturës e drejtë e butë (soft law), gjë që lë mundësinë që secili shtet t'i implementojë dispozitat dhe rekomandimet, duke ruajtur specifikat e sistemit të vet.

Drafti i Ligjit për zgjedhjen, përdorimin dhe vendosjen publike të simboleve nacionale është i harmonizuar me Legjislacionin Evropian, si dhe me kontratat ndërkombëtare të ratifikura

të Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Evropës, me të cilat definohet mbrojtja e identitetit nacional:

- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në vitin 1966;
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, në vitin 1965;
- Deklarata për të Drejtat e Pjesëtarëve të Pakicave Kombëtare ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore, në vitin 1993;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Themelore në vitin 1950;
- Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave, në vitin 1992;
- Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Nacionale, në vitin 1994;

IV SHPJEGIMI I INSTITUTEVE JURIDIKE THEMELORE

Në dispozitat themelore jepet lënda e ligjit dhe definohet se simbole nacionale konsiderohen simbolet të cilat pjesëtarët e popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera pakicë në Mal të Zi i përdorin për të shprehur identitetin e vet nacional.

Me nenin 3 të Draftit (projekt ligjit) definohet se simbolet nacionale janë stema dhe flamuri, se etaloni i stemës dhe etaloni i flamurit e miraton me vendimin e vet Këshilli përkatës i popullit pakicë ose komunitetit tjetër pakicë, në mënyrën siç parashikohet me statut dhe se këtë vendim e konfirmon Kuvendi i i Malit të Zi, ndërsa origjinali i stemës dhe origjinali i flamurit ruhen tek autoriteti i administratës shtetërore kompetent për të drejtat e pakicave.

Me nenin 4 të këtij Drafti definohet qartë se stema dhe flamuri përdoren vetëm në formë dhe përmbajtje të përcaktuar. Me nenin 5 të Draftit definohet se ku mund të përdoret stema, ndërsa me nenin 6 definohet se ku mund të vendoset flamuri. Gjithashtu, me dispozitat e nenit 7 janë definuar qartë rastet në të cilat rreptësisht ndalohet përdorimi i simboleve nacionale, e këto janë:

- 1) para dhe në objektet e Kuvendit të Malit të Zi, Presidentit të Malit të Zi, Qeverisë së Malit të Zi, Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi, Prokurorisë Shtetërore, Mbrojtësit të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Ushtrisë së Malit të Zi, Drejtorisë së Policisë, Bankës Qendrore të Malit të Zi dhe Institucionit Shtetëror të Auditimit;
- 2) me rastin e takimeve ndërkombëtare, politike, shkencore, kulturo-artistike, sportive dhe tubimet e tjera në organizimin e organeve nga pika 1 e këtij neni, si dhe në tubimet e tjera në të cilat prezantohet Mali i Zi;
- 3) Në rastet e tjera të parapara me ligj;

Në nenin 8 është dhënë e drejta që në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat pjesëtarët e popullit pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë **përbëjnë popullatën shumicë**, në ditët e festave nacionale të popullit pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë, para objektit të organit të organit të vetëqeverisjes dhe administratës lokale, krahas simboleve shtetërore, të vendosen edhe simbolet nacionale të popullit pakicë, ose të komunitetit tjetër pakicë, përkatës. Me paragrafin 2 të këtij neni, në të njëjtën situatë, gjegjësisht në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat pjesëtarët e popullit pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë përbëjnë popullatën shumicë, është i lirë përdorimi i simboleve nacionale edhe në objektet e organit të vetëqeverisjes dhe administratës lokale.

Neni 9 definon situatën kur pjesëtarët e popullit pakicë ose të komunitetit tjetër pakicë nuk e përbëjnë popullatën shumicë, por një pjesë të konsiderueshme të popullatës (mbi 15%) në njësitë e vetëqeverisjes lokale, kështu në ditët e festave nacionale, para objekteve të organit të vetëqeverisjes dhe administratës lokale, i jepet e drejta e vendosjes edhe e simbolit nacional, si përdorim i lirë i simboleve nacionale edhe në objektet e vetëqeverisjes dhe administratës lokale.

Në ambientet e vetëqeverisjes lokale të dedikuara për ceremoninë e kurorëzimit (martesës) është i lirë përdorimi i simboleve nacionale, çka është definuar me nenin 10 të këtij Drafti.

Pasi që është e nevojshme që kjo kornizë ligjore të përpunohet në statutet e njësisve të vetëqeverisjes lokale, e në drejtim të decentralizimit të kësaj çështjeje, me nenin 11 definohet detytimi që një mënyrë më e detajuar e përdorimit dhe vendosjes publike të simboleve nacionale të rregullohet me statutet e njësisve të vetëqeverisjes lokale.

Në një kapitull të veçantë, me disa nene është definuar mbrojtja e simboleve nacionale.

Në simbolet e përcaktuara nacionale nuk lejohet që asgjë të përmirësohet, shtohet apo ndysohet, kurse simbolet nacionale mund të përdoren si pjesë e emblemave, gjegjësisht simbole të institucioneve nacionale, me pëlqimin e mëparshëm të institucionit i cili i përcakton këto simbole (neni 12).

Me nenin 13 është përcaktuar ndalimi i përdorimit të simboleve nacionale në formë identike si simbole të partisë politike, sipërmarrjes, institucionit dhe subjektit ose organizatës tjetër juridike, ose të markës tregtare ose shërbimit, modelit ose mostrës, dhe as cilëndo shenje tjetër që shënon mallra ose shërbime. Po ashtu, me nenin 14 ndalohet përdorimi i simboleve nacionale nëse ato janë të dëmtuara, apo nëse për shkak të dukjes ato janë të papërshtatshme për përdorim.

Me nenet 15 dhe 16 të këtij Drafti është definuar edhe mënyra e përdorimit të flamurit.

Çdo përdorim, gjegjësisht vendosje e simboleve nacionale krahas simboleve shtetërore, nënkupton që simboli shtetëror zë vendin e nderit, çka është definuar me nenin 17 të këtij Projekt-ligji.

Projekt-ligji definon që kontrollin e inspektimit lidhur me zbatimin e tij e kryen autoriteti (organi) i administratës shtetërore që është përgjegjës për aktivitetet e inspektimit, në pajtim me ligjin e veçantë, ndërsa me nenin 19 janë paraparë dispozitat ndëshkuese për personat juridikë dhe fizikë, si dhe personi përgjegjës në subjektin juridik, nëse injorojnë normat e këtij ligji.

Në dispozitat kalimtare janë dhënë afatet për harmonizimin e statuteve të njësisve të vetëqeverisjes lokale dhe Këshillave, si dhe afati për përcaktimin e etaloneve të stemës dhe flamurit. Me dispozitat përfundimtare, me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushon të jetë në fuqi Ligji për përdorimin e simboleve nacionale ("Gazeta Zyrtare e RMZ", numër 55/00) dhe neni 107 i Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit me të cilat janë përcaktuar dënimet me para për kundërvajtje ("Gazeta Zyrtare e MZ", numër 40/11).

V VLERËSIMI I MJETEVE FINANCIARE TË NEVOJSHME PËR ZBATIMIN E LIGJIT

Për zbatimin e këtij ligji nuk nevojiten mjete financiare shtesë në Buxhetin e Malit të Zi.